



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË



REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Arsimit,
Shkencës dhe Teknologjisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË E KOSOVËS

Të nderuara kolege,
Të nderuar kolegë,

Duke ju përshëndetur, ju njoftojmë se si edhe më parë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) e Republikës së Shqipërisë do të organizojnë seminarin XV për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë.

Duke u mbështetur në kalendarët shkollorë të shteteve përkatëse dhe për të mundësuar pjesëmarrje të gjerë të mësuesve të diasporës, seminari i këtij viti do t'i zhvillojë punimet prej **31.07-03.08.2019, në Prizren** (adresa: Hotel "Theranda", Rruga "Adem Jashari" 1, 20000 Prizren).

Afati për paraqitjen e pjesëmarrjes është deri më **01 qershor 2019**.

Në seminar do të angazhohen **ligjërues/lektorë** shqiptarë (punonjës shkencorë, specialistë dhe ekspertë të arsimit, titullarë dhe zyrtarë shteti), si dhe ligjërues të huaj nga qarqet përkatëse profesionale të shteteve ku zhvillohet mësimi plotësues i gjuhës shqipe.

Pjesën tjetër do ta përbëjnë **prezantimet-ligjëratat profesionale** personale apo në grup, të ndërtuara mbi baza kërkimore-hulumtuese dhe empirike të vetë **mësuesve dhe të mësuesve** që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë shqiptarë në diasporë apo të **drejtuesve të shkollave** në të cilat këta nxënës ndjekin mësimin plotësues të gjuhës shqipe.

Si zakonisht, **tematika e prezantimeve** do të jetë rreth fushave a kategorive themelore kurrikulare e didaktike (gjuhë shqipe dhe letërsi shqiptare, histori dhe gjeografi, trashëgimi kulturore dhe artistike, metodologji të mësimdhënies, teoritë e të nxënësve etj.).

Organizatorët konsiderojnë që, një vit pas miratimit të kurrikulës së njësuar përkatëse kombëtare për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, ky edicion të ketë si të veçantë **një tryezë të hapur diskutimi me temën "Tekste, mjete dhe materiale mësimore të përbashkëta dhe dokumentacion pedagogjik sa më të njësuar"**.

Afati për aplikim me prezantim, kumtesë, ligjëratë, promovim didaktik etj., është deri më datën **01 qershor 2019**. Po deri më këtë datë duhet t'i dërgoni edhe abstraktet e prezantimeve, kumtesave etj., përkatëse me së paku 200 fjalë. Ndërkaq, njoftimin për pranimin, respektivisht futjen e prezantimit, kumtesës etj., në programin e seminarit, do ta merrni deri më **15 qershor 2019**.

Prezantimet nuk duhet të zgjasin më shumë se 30 minuta.

Deri më datën **01 korrik 2019** do të keni programin e plotë të seminarit.

Njoftimin e pjesëmarrjes bashkë me fletëparaqitjen përkatëse (shih në sirtar) duhet ta dërgoni në të dy adresat si më poshtë:

Nuhi.gashi@rks-gov.net dhe **anila.ferizaj@arsimi.gov.al**

Shënim: Luten kryetarët e këshillave a shoqatave të mësuesve, si dhe vetë mësuesit/et që këtë imejl ta shpërndajnë te të gjithë kolegët/et e tyre.

Me respekt,
Nuhi Gashi, Anila Ferizaj